



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr 6280 Prot.

Tiranë, më 22/12/2016

URDHËR

Nr 558 Datë 20/12/2016

PËR  
NGRITJEN E SHËRBIMIT PEDIATRIK PËR URGJENCAT MJEKËSORE TË  
MOSHËS PEDIATRIKE NË TIRANË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr.10107 datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për përballimin e situatës së krijuar nga semundshmërisë e lartë pediatrike gjatë stinës së dimrit:

URDHËROJ

1. Ngritjen dhe funksionimin e shërbimit për urgjencat mjekësore të moshës pediatrike në të gjitha qendrat shëndetësore të Tiranës.
2. Përveç ditëve të javës, shërbimi mjekësor për trajtimin e rasteve urgjente të sëmundshmërisë feminare do të organizohet dhe funksionojë edhe ditët e djela.
3. Krahas mjekut të familjes /të përgjithshëm, të djelën nga ora 8:00 e mëngjezit deri 20:00 të darkës, do të jetë në gadishmëri për këtë moshë dhe një mjek pediatër.
4. Drejtuesit e qendrave shëndetësore të Tiranës të garantojnë dhe vënë në dispozicion barnat e urgjencës mjekësore për këtë grupmoshë, sipas listës standarde të barnave të parashikuar në Paketën Bazë të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor.
5. Autoriteti Shëndetësor Rajonal i Tiranës është përgjegjës dhe monitoron organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi.
6. Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë ngarkohen për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet deri në datën 01.03.2017.

Konceptoi: E. Çomo/ P. Mersini

Konfirmoi: A. Çarçani

Datë: 20.12.2016

MINISTRI

ILIR BEQAJ